



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT
KOORDINATORI I TË DREJTËS PËR INFORMIM**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2021

Lënda: Kthim përgjigje në lidhje me kërkesën për informacion.

Z. Adrian Kati

Drejtor Ekzekutiv – QSHRT

Adresa: Rruga e Durrësit, P.125, K.3, H3

TIRANË

I nderuar z. Kati,

Ju bëjmë me dije për kërkesën tuaj për informim, në cilësinë (OJF), “Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës”, që lidhet me kërkesën e familjarëve të të pagjeturit (zhdukurit) Elez Islami i arrestuar në vitin 1949 -të dhe i zhdukur në burgun e Durrësit në vitin 1953, moment pas të cilit familjarët nuk kanë patur asnjë lajm për fatin e tij.

Ju informojmë se ky rast është trajtuar nga ana e Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, mbi bazën e ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” mbi bazën e kërkesës së familjarëve.

Me shkresë nr.45 prot., dt. 14.01.2020, shtetasja Sadije Hamza në cilësinë e afërmit, ka kërkuar marrjen e informacionit nëse shtetasi Elez Islami ka qenë ndonjëherë iurvejuar nga ish-Sigurimi i Shtetit dhe nëse ka dokumente për të në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit.

Bazuar në informacionet e administruara, nga verifikimeve e kryera, për shtetasin Elez Islami, nuk janë gjetur të dhëna, apo të ketë dokumente për të në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit.

Për sa më sipër në zbatim të urdhrin të vendimit nr. 325 datë 16.06.2020, është informuar shtetasja Sadije Hamza.

Gjithashtu me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të ligjit nr. 45/2015, për personin e pagjetur Elez Islami, si dhe për rastet analoge, do të kryhen të gjitha procedurat e nevojshme dhe të mundshme nga ana jonë, në kuadër të kërkimit për personat e pagjetur, në varësi të çdo informacioni, dokumenti apo indicje të vlefshme për këtë rast.

Do sugjeronim dhe konsideronim të vlefshëm dhe ndihmesë në përmbushjen e kësaj, mbështetjen dhe kontributin e familjarëve me çdo dokument, kujtime apo edhe me intervistim të posaçëm nga persona që kanë në funksion të këtij qëllimi.

Duke ju falënderuar

Koordinatori i të drejtës për informim pranë AIDSSH

Selami Zalli

E-MAIL: selami.zalli@autoritetidosjeve.gov.al.